



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRE - OPSTINA VUCITRN

254 / 21  
01 Nr. / Br. /  
Nr. i fq. / Br. si  
Data: / Date: 30.12.2021  
VUSHTRI - OPSTINA VUCITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI  
OPSTINA VUCITRN

### PROCESVERBAL

nga mbledhja e VIII-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më  
16 shtator 2021 në sallën e kryetarit të komunës, e cila filloj në ora 14:10.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Nasuf Aliu (kryesues), Melihate Basholli-Latif, Gresa Muli, Ymer Haradinaj, Shkëlzen Feka, Arta Ymeri, Nezir Klinaku dhe Teuta Aruçi Shartari (anëtarë të KPF-së).

Mungoi: Shpëtim Zhegrova.

*Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Afrim Namani, nënkyretar i komunës, Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Berat Sadiku, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrotje të Mjedisit si dhe nga sekretaria e kuvendit Bastri Duraku dhe Bujar Klinaku.*

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së, i cili konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

Aliu tha se është kërkesë e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa që mbledhja e kuvendit të komunës të mbahet më herët, pasi që e enjta e fundit është data 30 shtator, kurse kjo datë është edhe afati i fundit për dorëzimin e buxhetit në ministri. Prandaj, është mirë që të dakordohemi që ta mbajmë më herët mbledhjen e kuvendit.

**Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa** – tha se arsyja që kemi kërkuar që ta mbajmë më herët është për shkak se kemi me i futur të dhënat në sistem dhe se më datën 30 shtator është afat shumë i shkurtër, sepse po atë ditë duhet ta dorëzojmë buxhetin në ministri. Por, nëse doni mund ta thirrni një seancë të jashtëzakonshme vetëm për buxhet, tha ai.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – theksoi se nëse pajtohem si subjekte politike, mund ta mbajmë edhe më herët nuk ka ndonjë problem. Prandaj, do të ishte mirë që në fillim të çdo viti të hartohet kalendarri njëvjeçar për mbajtjen e seancave të kuvendit.

**Melihate Basholli Latifi, anëtare e KPF-së** – deklaroi se meqenëse është data e fundit 30 shtatori, nuk jam kundër nëse nuk është jashtëligjore.

**Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF-së** – tha se kur jemi pajtuar e kemi tejkaluar rregulloren e kuvendit.

**Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së** – edhe unë pajtohem që të mbahet më herët seanca.

**Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri u pajtuan që seanca e kuvendit të komunës të mbahet më 24 shtator 2021 në ora 14:00.**

**Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF- së** –tha se ka ardhur edhe një pikë shtesë për t'u futur në rend të ditës <Propozim vendim për përkrahje financiare për klubin e hendbollit “Vushttria”>

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – deklaroi se kjo pikë shtesë e rendit të ditës që ka ardhur, nuk ka arsyetim fare, por mungon edhe kërkesa e klubit. Prandaj, është mirë të na njoftoni se cili është qëllimi i saj? Prandaj, nëse ekziston kërkesa e klubit të sjellët në kuvend bashkë me arsyetimin

Ai propozoi që nëse ka mjete financiare të ndihmohet edhe klub i basketbollit.

**Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së** – edhe ne pajtohem i që të procedohet tutje, por të kompletohet me ato gjëra që i ceku parafolësi, sepse një arsyetim duhet patjetër ta ketë ky propozim vendim.

***Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:***

**R E N D D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 15 korrik 2021;
  2. Shqyrtimi i draft- buxhetit dhe planeve investuese për vitin 2022;
  3. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko- financiare dhe zbatimin e planeve investuese për periudhën janar-qershori 2021;
  4. Rishikimi i Planit të Veprimit për të gjeturat e Auditorit;
  5. Shqyrtimi i kërkesës së Ymer Ukiqit;
  6. Shqyrtimi i Propozim vendimit për përkrahje financiare për klubin e hendbollit “Vushttria”;
  7. Të ndryshme.
- 
1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 15 korrik 2021.

***Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 15 korrik 2021.***

2. Shqyrtimi i draft- buxhetit dhe planeve investuese për vitin 2022.

**Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa** – theksoi se buxheti për vitin 2022 është 19,862,886.00 € që kahasuar me buxhetin e vitit të kaluar është për 984,757.00 euro më i madh. Ai tha se nga ministria kemi kërkuar që të rriten komunalitë.

**Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF- së** –pyeti se tek pjesa hyrëse a është gabim teknik, sepse flitet për vitin 2020?

**Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa** – po, gabim teknik është.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

3. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investuese për periudhën janar-qershor 2021.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

4. Rishikimi i Planit të Veprimit për të gjeturat e Auditorit.

**Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa** – tha se raporti i auditorit është i pakualifikuar, kurse numri i rekomandimeve është më i vogël në krahasim me vitin 2019.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – theksoi se qeveria komunale ka pasur fat për gjetje nga auditori, sepse do të kishte edhe gjetje tjera. E kam thënë edhe atë ditë që u mbajt takimi me zyrën e auditorit e që u transmetua në televizon, shqetësuese është që auditori e përkrahte kryetarin që nuk mund të shpallet tender për mbulimin e shpenzimeve të varrimit të qytetarëve. E dini që kuvendi i komunës ka marrë vendim për mbulimin e shpenzimeve të varrimit nëse nuk gaboj në vitin 2017. Kryetari i komunës ka bërë marrëveshje me Bashkësinë Islame në Vushtrri pa procedurat e prokurimit publik. Me marrëveshjen e re, e keni hequr hapjen e varreve dhe e keni emërtuar si marrëveshje për rite fetare. Prandaj, ju e keni devjuar vendimin e kuvendit, ku thuhet se komuna t'i mbulojë shpenzimet e varrimit për qytetarët e Vushtrrisë.

Ruga në Nedakoc është dashur që të përfundojë në vitin 2019, kurse kjo rrugë as sot nuk është e përfunduar.

Pastaj, e gjetur tjetër është ndryshimi i lokacionit të depos së patates nga Pestova në Nedakoc. Prandaj, duhet ta thuani që ka të gjetura dhe se mirë është të përmirësohen.

**Berat Sadiku, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrotjtje të Mjedisit** – tha se asfaltimi i rrugës në Nedakoc ka filluar në vitin 2019 dhe është dashur që të përfundojë në vitin 2020 në bazë të planit dinamik. Për neve si qeverisje komunale ka qenë e rëndësishme që të bëhet funksionale rruga. Ai tha se muajin e kaluar janë shkëputur dy kontrata, për shkak të vonesave të paarsyeshme të këtyre dy kompanive: njëra është për punimet e mureve të betonit dhe tetra është për asfaltim. Po ashtu, është konfiskuar garancioni bankar në vlerë rreth 60 mijë euro, ku pjesa e 10% është mbetur pa paguar. Në total janë rreth 120 mijë euro në xhirollogarinë e komunës.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – tha se i vjen mirë që janë shkëputur kontratat, por nëse ka ndëshkime ndaj kompanive le të publikohen, sepse kryetari i komunës është zotuar se do t'i publikojë.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

5. Shqyrtimi i kërkesës së Ymer Ukiqit.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet tek drejtoritë kompetente.*

6. Propozim vendim për përkrahje financiare për klubin e hendballit “Vushtrria”.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që së bashku me kërkesën e klubit dhe arsyetimin nga drejtoria të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

7. Të ndryshme.

Mbledhja përfundoi në orën **14:50**.

Bujar Klinaku  
*B.Klinaku*  
Procesmbajtës

Nasuf Aliu  
*N. Aliu*  
Kryesues i KK-së dhe i KPF- së